



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 260, Datë 31.08.2023

MBI

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “POWER-ELEKTRIK-SLABINJË”
SH.P.K., PËR ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMIT TË BORDIT TË ERE NR. 166,
DATË 05.08.2021**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, “Kodit të Transmetimit” i miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 63, datë 12.04.2022; si dhe neneve 15 dhe 26 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.08.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1284/5 prot., datë 28.08.2023 të përgatitur nga Drejtoritë Teknikë, “Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Power Elektrik Slabinjë” sh.p.k., mbi zgjatjen e afatit të vendimit të bordit të ERE nr. 166, datë 05.08.2021”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “POWER-ELEKTRIK-SLABINJE” sh.p.k., është mbajtëse e licencës Nr. 93, Seria PV10K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 10, datë 08.02.2010, për një afat 30-vjeçar dhe modifikuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 95, datë 16.07.2012.
- Shoqëria “POWER – ELEKTRIK - SLABINJE” sh.p.k., është zotëruese e HEC “Slabinjë” me fuqi të instaluar 13.08 MW. Hidrocentrali nëpërmjet një nënstacioni ngritës TM/110 kV lidhet me rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria “POWER-ELEKTRIK-SLABINJE” sh.p.k., nëpërmjet shkresës së protokolluar në ERE me nr. 1284/2 prot., datë 20.07.2023, ndër të tjera ka bërë me dije se: *...Për të realizuar të gjithë proceset e parashikuara kërkohet një afat prej 36 muaj që të mund të realizohet lëvrimi i paisjeve, instalimi dhe testimi i paisjeve pasi ndërfaqja ndërmjet paisjeve kineze të HEC dhe atyre ABB të OST paraqet vështirësi të mëdha. Në këto kushte kërkojmë nga ERE zgjatjen e efekteve juridike të përcaktuara në pikën 1, gërma c, të derrogimit të përcaktuar me vendimin nr. 166, datë 05.08.2021. Zgjatja e efekteve juridike të vendimit nr. 166, datë 05.08.2021, prej*

një periudhe 36 muaj do të mundësonte realizimin e punimeve objekt kontrate dhe integrimin e plotë në sistemin SCADA të OST sh.a.”.

- Me qëllim konsultimin publik të kërkesës së bërë nga shoqëria “POWER ELEKTRIK SLABINJË” sh.p.k., u realizua publikimi në faqen e internetit të ERE-s në rubrikën konsultime në datën 21.07.2023. Deri më datën e kësaj vendimarrje nuk rezulton të jetë dërguar në ERE ndonjë opinion apo koment nga palët e interesit për kërkesën e shoqërisë “POWER - ELEKTRIK-SLABINJË” sh.p.k., mbi zgjatjen e afatit të vendimit të bordit të ERE-s nr. 166, datë 05.08.2021.
- Këshilli i Ministrave nisur nga situata e krijuar në tregjet e energjisë elektrike të cilat çuan në rritje të mëdha të çmimit të energjisë elektrike nëpërmjet Vendimit nr. 584, datë 08.10.2021, vendosi për shpalljen e gjëndjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike. Shoqëria në shkresën e dërguar në ERE më datë 20.04.2023 për “Informacion mbi ecurinë e zbatimit të vendimit të ERE-s. nr. 166. datë 05.08.2021, mbi shqyrtimin e kërkesës për derogim të shoqërisë "POWER - ELEKTRIK - SLABINJË" sh.p.k. shprehet dhe për rritjen e çmimeve të energjisë elektrike duke marrë në konsideratë ndikimin e kësaj të fundit në proceset e industrisë u shoqërua me një rritje çmimesh në shumë produkte ku nuk përjashtohen dhe paisjet për sistemet teknologjike SCADA. Gjendja e emergjencës në furnizimin me energji elektrike u shty deri më 31 Dhjetor 2022 me VKM-në nr. 256, datë 29.04.2022, me VKM-në nr. 650, datë 10.10.2023 u shty deri më 30 Qershor 2023 si dhe me VKM-në nr. 449, datë 26.07.2023 gjendja e emergjencës në furnizimin me energji elektrike u shty deri më 31 Dhjetor 2023.
- Derrogimi i kërkuar nga shoqëria “POWER ELEKTRIK SLABINJE” sh.p.k. dhe i miratuar nga ERE me vendimin nr. 166,
- datë 05.08.2021, me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 584, datë 8.10.2021, është aplikuar në kushtet e gjëndjes së emergjencës së furnizimit me energji elektrike.
- Shoqëria ka kërkuar zgjatjen e efekteve juridike të përcaktuara në pikën 1 gërma “c” të derogimit të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 166, datë 05.08.2021, me 36 muaj të tjerë. Në pikën 1 gërma (c) e vendimit të ERE-s është parashikuar: “Afati i derogimit është për një periudhë 24 muaj”, duke qënë se vendimi është parashikuar të hyjë në fuqi menjëherë periudha 24 mujore fillon në datën 05.08.2021 dhe përfundon në datën 05.08 2023.
- Shoqëria nuk ka kërkuar ndryshimin e objektit të derogimit, por vetëm zgjatjen e efekteve juridike të këtij derogimi, pa ndryshuar asnjë element të tij. Në këto rrethana duke qënë se jemi duke vlerësuar të njëjtin objekt derogimi të pandryshuar vlerësimet përkatëse janë trajtuar në mënyrë shteruese në procesin e vendimarrjes së bordit të ERE-s nr. 166, datë 05.08.2021.
- Detyrimet për lidhjen me sistemin SCADA të përdoruesve janë parashikuar në “Kodin e Transmetimit” të miratuar me vendim e bordit të ERE-s nr. 63, datë 11.04.2022, respektivisht neni 41 pika 3 gërma (d) ku përcaktohet detyrimi për diagramin e telekomunikacionit dhe lidhja me sistemin SCADA të OST. HEC i shoqërisë “POWER - ELEKTRIK – SLABINJË” sh.p.k., nuk është i lidhur me sistemin SCADA të OST sh.a., dhe vendimi i bordit të ERE-s nr. 166, datë 05.08.2021, në pikën 1 gërma (b) ka përcaktuar se shoqëria “POWER - ELEKTRIK

- SLABINJË” sh.p.k., të vijojë të operojë e lidhur me sistemin e transmetimit duke marrë në konsideratë sa përcaktuar në këtë derogim.

- Në këto kushte për shkak të shfuqizimit të “Kodit të Transmetimit” të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 186, datë 10.11.2017, i ndryshuar dhe hyrjen në fuqi të “Kodit të Trasmemit” miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 63, datë 11.04.2022, duhet të saktësohet pika 1 gërma (a) e parashikuar në vendimin nr. 166, datë 05.08.2021, si më poshtë vijon: *Derogimin/pezullimin e përkohshëm të përcaktimeve të nenit 41 pika 3 gërma (d) të Kodit të Transmetimit të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 63, datë 11.04.2022, për njësitë gjeneruese të shoqërisë “POWER – ELEKTRIK – SLABINJË” sh.p.k..*
- Në kuadër të vendimarrjes nr.166, datë 05.08.2021, në vijim të shkresës së ERE nr. 789/1 prot., datë 08.07.2021, OST sh.a., në përgjigje të kërkesës së bërë nga ERE, nëpërmjet shkresës nr. 4407/1 prot., datë 16.07.2021 ndër të tjera ka parashtruar se shoqëri të ndryshme të prodhimit të energjisë elektrike kanë zhvilluar dhe realizuar projektet e tyre në kohë të ndryshme. Në këto kushte edhe zhvillimi i sistemit SCADA të OST sh.a. ka qenë në zhvillim të vazhdueshëm. Për rrjedhojë shoqëritë e prodhimit të energjisë elektrike përfshi dhe shoqërinë “POWER ELECTRIK SLABINJË” sh.p.k. kanë implementuar teknologji dhe SCADA lokale e cila paraqet vështirësi për integrimin dhe ndërfaqjen me sistemin SCADA të OST sh.a. Po ashtu në këtë komunikim OST sh.a. është shprehur se: derogimi i paraqitur për opinion në OST sh.a. nuk çënon operimin dhe funksionimin normal të sistemit të transmetimit.
- Aktualisht kushtet e emergjencës në furnizimin me energji elektrike dhe kostot e shtuara si funksion i saj përbëjnë një situatë të paparashikuar më parë por shoqëria ka adresuar zgjidhjen duke firmosur një kontratë noteriale si garanci ligjore me kontraktorin për realizimin e punimeve pra ka realizuar një pjesë të procesit të punës së derogimit dhe për rrjedhojë vlerësohet të mos ketë një afat më të gjatë kohor se ai i dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 166, datë 05.08.2021 që i përfshinte këto procese pune.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të pranojë pjesërisht kërkesën e shoqërisë “POWER-ELEKTRIK-SLABINJË” sh.p.k., mbi zgjatjen e afatit të vendimit të bordit të ERE-s nr. 166, datë 05.08.2021.
2. Pika 1 gërma (a) e vendimit nr. 166, datë 05.08.2021, ndryshon dhe bëhet: *Derogimin/pezullimin e përkohshëm të përcaktimeve të nenit 41 pika 3 gërma (d) të Kodit të Transmetimit miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 63, datë 11.04.2022, për njësitë gjeneruese të shoqërisë “POWER-ELEKTRIK-SLABINJË” sh.p.k..*
3. Pika 1 gërma (c) e vendimit nr. 166, datë 05.08.2021, ndryshon dhe bëhet: *Afati i derogimit i përcaktuar në vendimin nr. 167, datë 05.08.2021, shtyhet për një periudhë 24 muaj deri më 05.08.2025.*

4. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë shoqërinë “POWER-ELEKTRIK-SLABINJË” sh.p.k. dhe shoqërinë OST sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI